



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 446/1 prot.

Shkodër, më 06.07.2022

Nr. 3686/1 Prot  
Dt. 12.07.22



**LËNDA: Mbi Vendimin nr. 42, datë 27.06.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.**

**KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja "a" dhe "c", neni 23, pika 14, neni 64, shkronja "gj", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut" si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", **shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 42, datë 27.06.2022 "Për lirimin e hapësirës publike pasuria nr.649, ZK 2236 të zënë në kundërshtim me ligjin, në fshatin Kosmaç, NJAD Bushat- Bashkia Vau Dejës"**.

Pas trajtimit, Prefekti konstaton se ky vendim nuk përfshihet në kategorinë e akteve normative. Për raste të tilla, ju thjesht duhet të zbatoni ka të miratuar vendimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës Nr.85 datë 25.11.2019 "Për vendosje gjobash, nivelin e tyre për shkelje që përbëjnë kundravajtje administrative" dhe vendimin Nr. 65, datë 26.10.2020 "Për lirimin e pronave dhe hapësirave publike të zëna në kundërshtim me ligjin, në Bashkinë Vau Dejës". Si pasojë, proceduralisht në vijë, është e mjaftueshme nxjerrja e një urdhëri nga organi ekzekutiv për ekzekutim individual të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T**

**Majlinda ANGONI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 42 datë 27.06.2022

**“Për lirimin e hapsirës publike të zëna në kundërshtim me ligjin, në fshatin Kosmaç,  
pasuria nr 649, zk 2236”**

Në mbështetje të nenit 54 të Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”,  
i ndryshuar ; relacion dt 02.06.2022 , Këshilli I Bashkisë :

**VENDOSI:**

1. Të merren masat për lirimin e hapësirës publike në fshatin Kosmaç, prona nr 649, zk 2236, ku sipas relacionit të grupit të punës rezulton e zënë nga banorët.
2. Ngarkohet Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit dhe Policisë Bashkiake për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETAR

Mark BISHA

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Ardian CELEPIJA



Miratuar me 19 vota

Vota Pro 17

Vota Kunder 1(90)

Vota Abstenim 1(90)

Zbardhur me datë 04.07.2022